

VENDIM
Nr. 74/2017

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN E KUVENDIT NR. 46/2017,
“PËR KRIJIMIN DHE PËRBËRJEN E KOMISIONIT AD HOC ME 6 ANËTARË TË
PËRZGJEDHJES SË KANDIDATËVE PËR INSTITUCIONET E RIVLERËSIMIT,
SIPAS LIGJIT NR. 84/2016, “PËR RIVLERËSIMIN KALIMTAR TË GJYQTARËVE
DHE PROKURORËVE NË REPUBLIKËN
E SHQIPËRISË”

Në mbështetje të nenit 78, pika 1, të Kushtetutës, nenit 55, pika 1, të Rregullores së Kuvendit, dhe të nenit 9, pikat 1, 2 dhe 3, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Kryetarit të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike dhe Kryetarit të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në vendimin e Kuvendit nr. 46/2017, “Për krijimin e Komisionit Parlamentar Ad Hoc të për zgjedhjes së kandidatëve për institucionet e rivlerësimit, sipas ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë””, me 6 anëtarë, të ndarë në mënyrë të barabartë midis shumicës dhe pakicës parlamentare, në pikën II bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

I. Në pikën II shkronja “b” nga grupet parlamentare të pakicës parlamentare caktohen:

1. Eduart Halimi (PD)
2. Flamur Noka (PD)
3. Albana Vokshi (PD)

II. Shtohet pika II/1 me këtë përmbajtje:

1. Vasilika Hysi caktohet kryetare (PS)
2. Eduart Halimi caktohet zëvendëskryetar (PD)

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ilir Meta

Miratuar në datën 22.5.2017